



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

DATE/A:	02.06.2021
PËR/ZA/TO:	Drejtorët e drejtorive komunale
NGA/OD/FROM:	Abit Abiti, ZKF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkore e brendshme Nr.1

Ministria e Financave me dt.14.05.2018 ka lëshuar Qarkoren Buxhetore 2022/01, ne këtë qarkore janë paraqitur kufijtë fillestar për secilën Organizatë Buxhetore si dhe afatet kohore. Qarkorja e pare buxhetore është e bazuar në Kornizën Afatmesme te Shpenzimeve 2022-2024 dhe merr parasysh prioritetet e caktuara me dokumentet strategjike, stabilitetin makro fiskal si dhe menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2022 dhe projeksionet për vitet 2023 dhe 2024 duhet të përfshihen këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën programeve në përputhje me planin kontabël
- Prioritet t'u jepet projekteve në vazhdimësi dhe projekteve për të cilat kemi kontrata.
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar për projekte kapitale
- Buxhetimi i projekteve të jetë në përputhje me Udhëzimin Administrativ MF 04/2019 për **Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale**

Kërkesat për shpenzime rrjedhëse duhet të jenë brenda kufijve buxhetor të përcaktuar me Qarkoren buxhetore 2022/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Në parim numri i të punësuarve do të mbetet i njëjtë me numrin e të punësuarve gjatë vitit 2021. Me Qarkoren e MFPT kemi një ndryshim të numrit të pozitive të aprovuara në Arsim dhe Shëndetësi Pagat dhe shtesat duhet të planifikohen me rritje vjetore të 0.5%

Mallrat dhe shërbimet duhet të buxhetohen mbi bazën e performancës, duke i identifikuar shpenzimet për aktivitete të cilat janë në përputhje me prioritetet e Komunës

Për shpenzimet komunale duhet të bëhet një analizë se sa ka kosto buxhetore shtesë shtrirja e ndriçimit publik dhe ndërtimi i objekteve të reja, gjithmonë duke pasur parasysh zbatimin e ligjeve në fushën e efikasitetit të energjisë.

Me qarkoren e MFPT rritja e subvencioneve është parashikuar të jetë rre 2%

Projektet Kapitale përfshijnë një pjesë të konsiderueshme në përqindjen e shpenzimeve të tërësishme për periudhën afatmesme kjo kategori pritet të ketë rritje rreth 4% . këto shpenzime duhet të jenë në përputhje me UA të cekur më lartë.

Para hartimit të projekt buxhetit hapësirë të veçantë duhet t'u japim dëgjimeve buxhetore të cilat do të organizohen në përputhje me situatën dhe rrethanat e krijuara nga pandemia COVID19

Planifikimi i Investimeve kapitale bëhet përmes Programit për investime publike (PIP), shënimet në këtë program në sistem i fusin zyrtarët e caktuar, mirëpo duhet tu ofrohen shënime konkrete për projektin nga zyrtarët e programeve në kuadër të të cilit zhvillohet projekti.

Granti i përgjithshëm.-Shuma e grantit të përgjithshëm është e përcaktuar me Nenin 24 të LFPL, krahasuar me vitin 2020 shuma e grantit të përgjithshëm është më e lartë për 6.06%.

Granti specifik për arsimin parauniversitar sipas LFPL merre parasysh kriteret e përcaktuara me formulën e MASHT-it, shuma e grantit është e përcaktuar në bazë të disa kriterëve, mirëpo kriteri kryesor është numri i nxënësve të regjistruar në vitin 2020/2021. Shuma e këtij granti krahasuar me vitin 2020 është më e lartë për 2.88%

Shuma e grantit specifik për shëndetësi është e njëjtë sikur gjatë vitit të kaluar.

Komune e Vushtrisë menaxhon me **Shërbimet rezidenciale**, për këtë qëllim janë ndarë 180,000.00€

Planifikimi i të **hyrave vetanake** është e bazuar në vlerësimet makro fiskale nga departamenti për politika fiskale.

Projeksionet tona për vitin 2022 kanë qenë më të larta, mirëpo shuma e aprovuar për Komunën e Vushtrisë është 2,262,795.00. Kjo shumë krahas granteve i shtohet financimit të Komunal.

Kufijtë buxhetor.

Gjatë planifikimit të planifikimit të buxhetit duhet të respektohen kufijtë buxhetor. Komisioni i granteve për Komunën e Vushtrisë sipas LFPL-së i ka ndarë shumat të cilat janë të paraqitura në Qarkoren Buxhetore 2022/01, kurse ne i kemi përmbledhur në tabelën më poshtë.

Tabela

	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2020/2021	%
Granti i përgjithshëm	6,709,131.00	7,115,388.00	7,432,974.00	7,793,226.00	406,257.00	6.06
Granti i arsimit	7,661,677.00	7,882,034.00	8,276,135.00	8,689,942.00	220,357.00	2.88
Granti për shëndetësi	2,425,419.00	2,425,419.00	2,546,690.00	2,674,024.00	-	-
Shërbimet Rezidenciale	175,000.00	177,250.00	180,000.00	180,000.00	2,250.00	1.29
Gjitsejt grantet	16,971,227.00	17,600,091.00	18,435,799.00	19,337,192.00	628,864.00	3.71
të hyrat vetanake	1,906,903.00	2,262,795.00	2,378,088.00	2,480,722.00	355,892.00	18.66
Totali	18,878,130.00	19,862,886.00	20,813,887.00	21,817,914.00	984,756.00	5.22

Kalendari kohor.

- Deri më 30 Qershor: aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale
- Deri më 30 Shtator aprovimi i propozim Buxhetit Komunal dhe dërgimi i tabelave 4.1, 4.2 dhe 4.3 në MFPT.

Gjatë kësaj kohe e deri te miratimi i propozim buxhet nga Kuvendi Komunal duhet të zhvillohen konsultime buxhetore me palët me interes.

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor

Me qëllim të respektimit të barazisë gjinore së bashku me tabelat e cekura më lart duhet të plotësohen edhe tabelat për Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor dhe atë tabela:

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore përkatëse

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit që janë gra	Numri total i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2022 Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore

Niveli i pagave	Numri total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel.	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400					
401-600					
600+					

Siç e cekëm më lartë deri më 30 Qershor duhet ta miratojmë Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale, në këtë dokument strategjik duhet të merret parasysh :

- Vizionin e Komunës
- Prioritetet afatmesme
- Struktura e veprimtarive ekonomike bazuar në të dhënat e marra nga ARBK
- Tabela e planifikimi i të hyrave vetanake
- Plan komunal i bashkëfinancimit sektorial me ministrinë e linjës dhe donatorët
- Planifikimi i buxhetit në kuadër të programeve dhe nënprogrameve
- Planifikimi i buxhetit për kategori ekonomike.
- Informacione për programet
- Asistim i mbajtësve të buxheteve gjatë futjes së shënimeve në PIP dhe SZHMB

Për qëllime të planifikimit të projekteve kapitale për Kornizën Afatmesme Komunale, kemi krijuar disa tabela, të cilat më vonë do të jenë pjesë e KAB-it Komunal.

[illegible]